

URDHËR
Nr. 7, datë 18.1.2022

**MBI BASHKËPUNIMIN CIVIL-USHTARAK NË FUSHËN E MENAXHIMIT TË
HAPËSIRËS AJRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të pikës 4, neni 102, të Kushtetutës, së Republikës së Shqipërisë; të pikës 1, neni 9, të ligjit nr. 96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”; të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, kreu V, “Mbrojta e infrastrukturës kritike dhe trashëgimisë kulturore”, neni 43, “Infrastruktura kritike”, dhe të shtojcës 1 të rezolutës A40-4, së miratuar nga sesioni i 40-të i Asamblesë së ICAO-s, mbi Bashkëpunimin Civil-Ushtarak në Menaxhimin e Trafikut Ajror, duke konsideruar:

1. që hapësira ajrore është një burim i përbashkët për aviacionin civil dhe ushtarak, dhe shërbimet e lundrimit ajror ofrohen dhe përdoren nga aviacioni civil dhe aviacioni ushtarak, në mënyrë efektive dhe efikase gjatë kryerjes së operimeve të tyre; dhe

2. që përdorimi fleksibël i hapësirës ajrore nga trafiku ajror civil dhe ushtarak mund të konsiderohet si synimi përfundimtar dhe përmirësimi i koordinimit dhe i bashkëpunimit civil dhe ushtarak ofron një qasje të menjëhershme drejt menaxhimit më efektiv të hapësirës ajrore dhe garantimit të sigurisë kombëtare, në raste krizash dhe të situatave emergjente me karakter kombëtar, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ministri i Mbrojtjes,

URDHËROJMË:

1. Përdorimi i përbashkët nga aviacioni civil dhe ushtarak i hapësirës ajrore dhe shërbimet që ofrohen për këtë qëllim do të organizohen në mënyrë që të garantojnë sigurinë në operim (*safety*), rregullsinë dhe efikasitetin ekonomik të operatorëve civilë të aviacionit, si dhe për të siguruar përmbushjen e kërkesave kombëtare të trafikut ajror.

2. Ofruesit e shërbimeve të lundrimit ajror dhe strukturat ushtarake të Forcave Ajrore të Republikës së Shqipërisë të planëzojnë dhe të zbatojnë programe për ndarjen e infrastrukturave dhe burimeve reciproke për të gjitha shërbimet respektive të lundrimit ajror, për sa kohë kjo nuk kufizon misionin e forcave ajrore.

3. Kostot për programet e përbashkëta do të ndahen proporcionalisht, sipas rastit dhe palës përfituese.

4. Ngarkohen Forcat Ajrore të Republikës së Shqipërisë dhe ofruesit e Shërbimeve të Lundrimit Ajror të bëjnë marrëveshje bashkëpunimi, sipas objektivave dhe interesave reciprokë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

MINISTËR I MBROJTJES
Niko Peleshi